




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2.0/DPK</u>	Nr. Prot. Br Prot. <u>01-4587/12</u> Prot No.
Nr. i faq Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Data Datum <u>24.12.2012</u> Date
PR. SHITINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **14.12.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3632/12, për ztr. *Fatos Berisha* – Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, *për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3632-12, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit.**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3632-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Fatos Berisha – Drejtor në Qendrën Kinematografike të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Sipas informacionit të pranuar, është shfaqë dyshimi lidhur me atë se; a përbën konflikt interesi angazhimi i zyrtarit të lartë – Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, në rolin e regjisorit të një shfaqje teatrale në Teatrin Profesionistë të Mitrovicës.

Pas kësaj shkrese njoftuese, kemi organizuar takim në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me Drejtorin e Departamentit të Kulturës, nga i cili jemi njoftuar se Ministria nuk e ka mbështetur regjisorin e kësaj shfaqje, por e ka mbështetur Teatrin e Mitrovicës, siç i mbështete

edhe Teatrot tjera Profesioniste të vendit. Po ashtu nga MKRS-ja kemi marrë edhe informacione me shkrim me datën 19.11.2012, me numër protokoli; DPK/DMP-03-4218/12.

Po ashtu me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr. 04/L-051, të ushtrimit i veprimtarive tjera nga zyrtari i lartë, në nenin 10 pika 2 shprehimisht thuhet: ***"Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera"***.

Në bazë të kësaj pike të ligjit, si dhe informacioneve zyrtare të marra nga MKRS dhe nga zyrtari i lartë i përfshirë në këtë rast (ndër të tjera edhe lejimin nga institucioni i tij ), kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se nuk ka pas situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

